




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurençiju - Competition Authority



Nr. 30/2023  
17.03.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 35, neni 36 paragrafi 6, nenit 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, bazuar në iniciativën e parashtruar nga GeoTech Sh.p.k. kundër Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 17.03.2023 merr këtë:

## K O N K L U Z I O N

Me të cilën Autoriteti i Konkurrencës, pas shqyrtimit paraprak dhe vlerësimit të situatës në tregun përkatës, konstaton se nuk ka kushte për të filluar procedurën ndaj Agjencisë Kadastrale të Kosovës sipas nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## A r s y e t i m

Iniciativa për fillimin e procedurës:

Autoriteti i Konkurrencës, më datë 27.09.2022 ka pranuar një ankesë nga kompania Geotech Sh.p.k, kundër Agjencisë Kadastrale të Kosovës(më tutje: AKK) lidhur me propozimin për fillimin e procedurës dhe caktimin e masës së përkohshme ndaj AKK-së.

Sipas palës ankuese, njoftimi "Informim Obligues" me nr. prot: 04/967/22 i dt. 08.07.2022 i lëshuar nga Agjencia Kadastrale është në kundërshtim me fryshtetuese dhe legjislacionin në fuqi pasi aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg dhe të njëjtat duhet të evitojnë favorizimin dhe krijimin e ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrje tjera të janë konkurruese e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 29 me nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, neni 35 par. 1, neni 39, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka autorizuar grupin e punës, të siguroj të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak lidhur me rastin në fjalë.

Pretendimet e palës ankuese:

Agjencia Kadastrale e Kosovës me njoftimin e datës 08.07.2022 me titullin "Informim Obligues" i ka njoftuar të gjitha Zyrat Kadastrale Komunale të Republikës së Kosovës, kompanitë gjeodezike dhe gjeodetët e licencuar se i vetmi sistem i pozicionimit satelitor në Republikën e Kosovës është sistemi i ashtuquajtur KOPOS, i cili mirëmbahet dhe menaxhohet nga AKK. Gjithashtu janë njoftuar se janë të obliguar që të gjitha matjet kadastrale të cilat dorëzohen në Zyrat Kadastrale Komunalë apo në Agjencinë Kadastrale Komunale si dhe në institucionë tjera shtetërore, e që si element e kanë përcaktimin e njësive kadastrale, t'i bëjnë

duke u shërbyer vetëm me shërbimet dhe instrumentet e KOPOS, duke i paralajmëruar se do t'i bartin pasojat ligjore në rast se konstatohet se për matjet kadastrale të cituara më lartë shërbehen me ndonjë sistem tjetër.

Meqenëse kompania GeoTech Sh.p.k. ofron shërbime precise dhe të besueshme të sistemit të pozicionimit si distributor i kompanisë prestigjioze TOPCON, njoftimi i përshkruar si më lartë i quajtur "Informim Obligues" i cenon interesat e kompanisë sonë, andaj në rastin konkret kemi legjitimitet të plotë të parashtrojmë këtë propozim dhe të jemi palë në këtë procedurë. Konsiderojmë së njoftimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës është nxjerrë pa dhënë asnje bazë të vlefshme juridike dhe se me anë të këtij informimi nuk është sqaruar se të njëjtë a i paraprinë ndonjë vendim i mëparshëm i AKK-së, Qeverisë apo Ministrisë përkatëse.

Nga përbajtja e këtij njoftimi shihet qartë se i njëjtë është i paligjshëm, është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj i cili e lejon Agjencinë Kadastrale të Kosovës, të kufizojë përdorimin e sistemit të pozicionimit vetëm tek një operator siç është KOPOS. Konsiderojmë se mënyra e tillë e vendosjes është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, duke e favorizuar një sistem të pozicionimit siç është KOPOS dhe duke i diskriminuar sistemet tjera që janë edhe më të sofistikuara.

Një praktikë e tillë e vendosur nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës nuk përkon fare me praktikat e shteteve demokratike, ku shërbimet e sistemit të pozicionimit janë të orientuara në sektorin privat apo atë publik-privat.

Njoftimi "Informim Obligues" i lëshuar nga Agjencia Kadastrale është në kundërshtim me fryshten kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi pasi aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg dhe të njëjtat duhet të evitojnë favorizimin dhe krijimin e ndërmarrjeve që zoterojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrje tjera të janë konkurruese e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Një njoftim i tillë i lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e pamundëson zhvillimin e një mjedisi konkurrues i cili do të siguronte se do të ketë hyrës potencial në garë për të prodhuar produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Pasi që konkurenca e fuqishme përbën nxitësin kryesor të rritjes së produktivitetit dhe siguron se tregu do të mbetet konkurrues dhe i jepet mundësi të zgjedhjes klientëve për shërbime më të mirë, cilësi, çmimi konkurruese dhe produkte të reja.

Po ashtu veprimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës bien ndesh edhe me Ligjin mbi Mbrojtjen e Konkurrencës, duke e favorizuar vetëm sistemin e pozicionimit KOPOS e cila gjë do ta ndryshoj strukturën e gjendjes së tregut në ofrimin e këtyre shërbimeve, dhe do ta pengojë qasjen e barabartë të konkurrentëve e që implementimi i mëtutjeshëm i "Informimit Obligues" do t'i çorientoj konsumatorin në besimin se ndërmarrjet tjera që veprojnë në Republikën e Kosovës që i përdorin sistemet tjera të pozicionimit përvëç sistemit që ka caktuar Agjencia Kadastrale e Kosovës janë jo të besueshëm. Andaj, me këtë rast Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke shkaktuar dëme të mëdha propozuesit si dhe subjekteve ekonomike që mirën më të njëjtën veprimtari. Është me rëndësi të theksohet se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës prandaj Agjencia Kadastrale e Kosovës me veprimin e saj e ka vendosur në pozitë të pafavorshme konkurruese paraqitësin.

Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat i propozojmë Autoritetit të Konkurrencës pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të pretendimeve të përshkruar më lartë të marrë këtë vendim:

Autoriteti i Konkurrencës të konstatojë se Njoftimi "Informim obligues" i datës 08.07.2022 me numër të protokollit 09/967/22 i lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës është në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e Konkurrencës.

Të urdhërohet Agjencia Kadastrale e Kosovës që në afatin e caktuar ta shfuqizojë këtë njoftim “Informim Obligues”.

Meqenëse me lëshimin e njoftimit të cekur më lartë ka rrezik për dëmtim të pariparueshëm të konkurrencës në treg, ku paraqitësit të kërkesës do t'i shkaktohej dëm i madh material dhe në rast se Komisionit tuaj i nevojitet kohë të filloj procedurat për hetim të thelluar, andaj në mënyrë që të mënjanohen efektet e dëmshme në konkurrencën në treg propozojmë që bazuar sipas nenit 49 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës të caktohet masa e përkohshme ashtu që i urdhërohet Agjencisë Kadastrale të Kosovës që për 6 muaj të ndalojë zbatimin e njoftimit “Informim obligues”, deri në vodosjen sipas propozimit.

Shqyrtimi paraprak i tregut relevant dhe korniza ligjore:

Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në nenin 35 - Iniciativa për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio nenin 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 3, paragrafi 10 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës e definon përkufizimin Ndërmarrje sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon:

*“Ndërmarrje - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike”.*

AKK-ja, vepron si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ambientit. Agjencia Kadastrale e Kosovës sipas politikës së konkurrencës, nuk konsiderohet ndërmarrje në kuptim të nenit 3 Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, që kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg.

Në Republikën e Kosovës, çështjet lidhur me kadastrën e pronës së paluajtshme si dhe matjet shtetërore rregullohen dhe administrohen në mënyrë të detajuar me dispozitat ligjore dhe rregullore të veçanta, konkretisht me ligjin nr. 04/L-013 për Kadastër, si dhe udhëzime administrative. Kushtet e hapjes së tregut për certifikimin e operatorëve të tjerë që merren me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të stacioneve permanente të pozicionimit global, të cilat në thelb kanë të bëjnë me të drejtën përmarrë pjesë, është çështje e mbikëqyrjes në kompetencë të organeve të administratës shtetërore/qendrore bazuar në ligjin nr. 04/L-013 për Kadastër.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlen edhe përmarrjet të cilave, në bazë të rregulloreve të veçanta, u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ndërmarrjeve që për nga natyra e tyre janë monopole dhe që krijojnë të ardhura ose atyre, në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive të caktuara, u është besuar kryerja e një veprimtarie të caktuar dhe atë vetëm në rastet kur zbatimi i LMK-së nuk do të pengonte, ligjërisht dhe faktikisht, kryerjen e detyrave që u përcaktohen me rregullore dhe masa të veçanta dhe përmarrjet janë krijuar këta persona.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet përmarrjeve që fiksimin e çmimit, abuzimin me fuqinë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë

dominuese në treg. Pretendimet e iniciuesit për fillim të procedurës kundër Agjencisë Kadastrale të Kosovës janë çështje që rregullohen dhe administrohen në mënyrë të detajuar me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta, konkretisht me Ligjin nr. 04/L-013 për Kadastër. Autoriteti i Konkurrencës, duke pasur parasysh kompetencat e saj ligjore, nuk është kompetente në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve.

Autoriteti i Konkurrencës, me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, të organeve qendrore të administratës publike, personave juridikë me autoritet publik dhe organeve lokale jep mendime profesionale për ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut si dhe t'u japë mendim për pajtueshmërinë e ligjeve ekzistuese dhe rregullave tjera me këtë ligj, ofron mendime me të cilat nxitë njohjen për konkurrencën e tregut, respektivisht ngritë nivelin e vetëdijesimit dhe informimit për rolin e ligjit dhe politikën e konkurrencës së tregut, si dhe ofron mendime dhe opinione profesionale për zgjidhjen dhe zhvillimet krahasuese të praktikave në fushën e legjisacionit dhe politikat e konkurrencës tregtare.


Andaj, nga sa u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

### AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

  
Neime Binaku - Isufi  
Kryetare

  
Kaltrina Sela  
Nënkyryetare

  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PRISHTINË/A  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY  
KONKURENCËS  
ADMINISTRATIV

  
Nafije Osdautaj  
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLUSION të njoftohen:

- Pala ankuese
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva